

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7995  
E mërkurë, 19 shkurt 2025  
Çmimi 0.50 €

## QEVERIA E HAJNAVE!

FAQE 5



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

# PAS ZGJEDHJEVE AKTIVIZOHEN AMBASADORËT E QUINTIT

FAQE 4-6

## OPINION

SULMET SISTEMATIKE NGA  
SERBIA GJATË LUFTËS NË  
KOSOVË DHE PLANI 'PATKOI' F. 6

Prof. dr. Fejzulla  
BERISHA




## AKTUALE



ÇFARË MËSUAM NGA BISEDIMET  
SHBA - RUSI NË ARABINË SAUDITE? F. 2

EDITA TAHIRI: SHQETËSUERE POZITA  
E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË NË  
RAPORT ME SHBA-në F. 3

## EKONOMI



GLPS PADITË MINISTRINË E  
FINANCEVE F. 8

BIZNESET KËRKOJNË HEQJEN  
E TARIFËS PËR PAGESAT  
ELEKTRONIKE ME POS F. 8

## SPORT



DARDANET NISIN PËRGATITJET  
PËR LIGËN E KOMBEVE F. 8



Ambasadorët nga disa shtete të  
Quintit dhe i dërguari evropian  
në Kosovë kanë zhvilluar të  
hënën takime të ndara me  
liderët e partive politike në  
Kosovë. Temë e diskutimeve

kanë qenë hapat e ardhshëm  
pas zgjedhjeve parlamentare të  
9 shkurtit. Mesazhi i  
ambasadorëve të huaj ishte se  
qeveria e re duhet t'i ndjekë  
reformat për t'iu bashkuar BE-

së. Ndërkaq liderët politikë  
kanë theksuar se presin që  
Komisioni Qendror Zgjedhor ta  
mbyllë sa më shpejt procesin e  
numërimit dhe certifikimit të  
rezultateve

KOSOVA KËRKON  
NGA KALLASI  
HAPA KONKRETË  
PËR TA DETYRUAR  
SERBINË  
T'I HAPË ARKIVAT  
SHTETËRORE F. 3



VITI 2025  
NIS ME RITJE  
ÇMIMESH NË  
KOSOVË,  
INFLACIONI NË  
JANAR 1.5 % F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Çfarë mësuam nga bisedimet ShBA - Rusi në Arabinë Saudite?

WASHINGTON, 18 SHKURT - Zyrtarë të lartë amerikanë dhe rusë kanë përfunduar bisedimet e tyre të para lidhur me luftën në Ukrainë, derisa Moska ka paraqitur kërkesa të reja për zhvillimin e negociatave të gjera për t'i dhënë fund konfliktit gati trevjeçar.

Takimi prej gati pesë orësh në Riad është pjesë e një përpjekjeje të madhe diplomatike nga Shtetet e Bashkuara për t'i dhënë fund luftës dhe u përshkruan nga zyrtarët amerikanë si diskutime eksploruese që mund ta hapin rrugën për një takim të mundshëm ballë për ballë ndërmjet presidentit amerikan Donald Trump dhe presidentit rus Vladimir Putin.

Pas përfundimit të bisedimeve në kryeqytetin saudit, zyrtarët rusë u thanë gazetarëve se diskutimet ishin një hap i parë i mirëpritur. Këshilltari kryesor për politikën e jashtme i Rusisë, Yury Ushakov, i cili ishte pjesë e delegacionit të vendit, tha se takimi "shkoi mirë".

Ushakov, gjithashtu, tha se të dyja palët ranë dakord që negociatorët të diskutojnë për Ukrainën dhe se përmendën shkurtimisht kushtet e nevojshme për një samit Putin - Trump. Ai shtoi se vendimi për të nisur bisedime më të thella me Shtetet e Bashkuara rreth Ukrainës në fund të fundit do t'i takojë vetë Putinit. "Ne jemi të gatshëm për këtë, por ende është e vështirë të

flasim për një datë specifike për takimin e dy liderëve", tha Ushakov, i cituar nga "Associated Press".

Departamenti amerikan i Shtetit tha se delegacionet nga të dyja vendet janë pajtuar t'i "adresojnë çështjet e ndjeshme" në marrëdhëniet e tyre me qëllim të normalizimit të lidhjeve diplomatike pas viteve të tensioneve.

Zëdhënësja Tammy Bruce tha në një deklaratë se Moska dhe Uashingtoni ranë dakord të caktojnë ekipe të nivelit të lartë për bisedimet rreth Ukrainës, "duke punuar për një rrugë për t'i dhënë fund konfliktit në Ukrainë sa më shpejt të jetë e mundur, në një mënyrë që është e qëndrueshme, e vazhdueshme dhe e



pranueshme për të gjitha palët". Ajo shtoi se të dyja vendet do ta eksplorojnë "bashkëpunimin e ardhshëm", por paralajmëroi se një afat i saktë mbetet ende i paqartë, duke vënë në dukje se

"një telefonatë e ndjekur nga një takim nuk është e mjaftueshme për të vendosur një paqe të qëndrueshme", derisa theksoi se bisedimet në Riad janë një hap i hershëm në një proces më të gjatë.

## Egjipti po punon në plan për rindërtim të Gazës pa e zhvendosur popullsinë

KAJRO, 18 SHKURT - Egjipti është duke zhvilluar një plan për ta rindërtuar Rripin e Gazës, që nuk parasheh largimin e palestinezëve nga territori i tyre, teksa shtetet arabe po tentojnë ta minimizojnë propozimin e presidentit amerikan Donald Trump për t'i larguar banorët nga zona, dhe që Shtetet e Bashkuara ta marrin kontrollin e territorit. Plani, sipas një raportimi të medias shtetërore të Egjiptit, Al-Ahram, bën thirrje për krijimin e "zonave të sigurta" brenda Gazës, ku palestinezët do të mund të qëndrojnë derisa kompanitë ndërtuese prej Egjiptit dhe vendeve të tjera ta rindërtonin infrastrukturën. Tri zonat e sigurta do të



funkcionin për një periudhë fillestare gjashtëmujore, sipas planit.

Shtëpitë mobile do të mund të krijoreshin dhe do të mundësohej dërgimi i ndihmave humanitare, parasheh plani.

Ky projekt rindërtimi - që mund të zgjasë pesë vjet - do të ofronte mijëra vende pune për banorët e Gazës, ka thënë një zyrtar i Egjiptit për agjencinë e lajmeve Associated Press (AP).

Dy zyrtarë të Egjiptit dhe diplomatë perëndimorë i kanë thënë AP-së se Kajroja është duke diskutuar planin me zyrtarë në Evropë, Arabinë Saudite, Katarin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Në këto negociata është thënë se po diskutohen edhe ndarjet buxhetore.

Më 4 shkurt Trumpi i ka thënë kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu, pas një takimi në Shtëpinë e Bardhë, se "ShBA-ja do ta marrë kontrollin e Rripit të Gazës dhe do të punojë në të". "Ne do ta zotërojmë atë", pati thënë Trumpi.

Sipas presidentit amerikan, palestinezët që aktualisht jetojnë aty do të duhet të zhvendosen përjetësisht në vendet arabe të rajonit dhe që

Shtetet e Bashkuara do të jenë në krye të përpjekjeve për ta shndërruar Gazën në "rivierë të Lindjes së Mesme".

Më shumë se 2.3 milionë njerëz jetojnë në Gazë, dhe shumica e tyre veçse janë zhvendosur si pasojë e luftës 16-mujore mes ushtrisë izraelite dhe Hamasit - grup palestinez i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Palestinezët kanë thënë zëshëm se nuk do të largohen prej tokës së tyre.

Sipas raportimeve në medie, edhe Arabia Saudite është duke çuar përpara një plan për ta përmbysur planin e Trumpit. Egjipti, Jordania dhe Emiratet besohet se janë të përfshira në këto përpjekje, pasi ato kanë

thënë se nuk janë të gatshme ta strehojnë popullsinë e Gazës.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i cili ka arritur në Izrael më 15 shkurt, në kuadër të një vizite në Lindje të Mesme, ka shprehur mbështetje të plotë për synimet e Izraelit në Rripin e Gazës dhe ka thënë se Hamasi "duhet të shfaroset".

Izraeli dhe Hamasi kanë arritur marrëveshje armëpushimi për t'iu dhënë fund luftimeve të nxitura nga grupi ekstremist, i cili ka sulmuar jugun e Izraelit më 7 tetor 2023, duke vrarë rreth 1 200 njerëz. Megjithatë, armëpushimi mbetet i brishtë, ndonëse Hamasi është duke liru pengje izraelite në këmbim të të burgosurve palestinezë që janë mbajtur në Tel Aviv.

## BE-ja i kërkon Serbisë të mos i forcojë lidhjet me Rusinë

Bruksel, 18 shkurt - Bashkimi Evropian e ka përsëritur thirrjen ndaj Serbisë si vend kandidat për anëtarësim që ta përshtatë qëndrimin e saj në politikën e jashtme me atë të BE-së dhe t'i evitohet hapat që janë në kundërshtim me këto qëndrime. Sipas diplomatëve të BE-së, kjo kërkesë vlen sidomos lidhur me qëndrimet ndaj Rusisë, kundër së cilës BE-ja vazhdon të vendosë sanksione për shkak të luftës së nisur në Ukrainë, ndërkohë që Serbia vazhdon të kultivojë raporte miqësore

me Rusinë.

Një zëdhënës i BE-së, duke iu referuar vizitës së fundit të ministrit të Jashtëm të Serbisë, Marko Gjuriq, në Moskë, dhe takimit të tij me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergej Lavrov, ka thënë se BE-ja ka marrë hapa për ta izoluar Rusinë, i ka ulur në minimum kontaktet, dhe po përgatit edhe një paketë të re sanksionesh, andaj pret që Serbia si vend kandidat të mos ndërmarrë hapa kundër kësaj politike të Bashkimit Evropian. "Serbia si vend kandidat duhet t'i shtojë përpjekjet për t'u



përshtatur me politikën e jashtme të BE-së si çështje me shumë prioritet. Prandaj

duhet të përmbahet nga veprimet apo deklaratat të cilat shkojnë kundër

qëndrimeve të BE-së në politikën e jashtme", ka thënë një zëdhënës i BE-së.

Ndërkohë, diplomatë nga disa vende anëtare kanë thënë se, krahas mungesës së progresit në procesin e normalizimit të raporteve me Kosovën, çështjeve të sundimit të ligjit, edhe bashkëpunimi i ngushtë i Serbisë me Rusinë ka ndikim që të mos hapen disa kapituj negociues në procesin e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE, edhe pse Serbia, sipas Komisionit Evropian, i ka përmbushur kushtet teknike për këtë.



## Rreth 200 mysafirë morën pjesë në ngjarjen e organizuar nga Konsullata e Kosovës për 17-vjetorin e Pavarësisë

**NJU-JORK, 18 SHKURT** - Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju-Jork ka mbajtur një ngjarje festive me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Në të morën pjesë rreth 200 mysafirë, nga të cilët 50 ambasadorë dhe diplomatë të shteteve anëtare të OKB-së, (përfshirë edhe shtete jonjohëse), zyrtarë amerikanë e përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Shefi i Misionit në Konsullatën

e Përgjithshme të Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka folur për rrëfimin e suksesshëm të shtetndërtimit demokratik të Kosovës, pas luftës çlirimtare kundër kolonializmit, apartheitit dhe gjenocidit të Serbisë kundër shqiptarëve. "Lavdi UÇK-së dhe kryekomandantit Adem Jasharit, falënderim i përjetshëm ShBA-së dhe NATO-s", ka theksuar Reka. Në emër të ShBA-së këtë përvojë e uroi John Kelly nga

Misioni i Përhershëm i ShBA-së në OKB, i cili në fjalën e tij tha se është nder të festojmë bashkë ditën e Pavarësisë së Kosovës. "Në emër të popullit të ShBA-së ju lutem pranoni urimet më të ngrohta për Ditën e Pavarësisë. Lidhjet midis popujve tanë janë të forta. Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës është momenti për t'i nderuar të arriturat e kaluara dhe për të shikuar drejt së ardhmes së ndritshme dhe lidhjeve më të ngushta midis shteteve tona".



## Kosova kërkon nga Kallasi hapa konkretë për ta detyruar Serbinë t'i hapë arkivat shtetërore

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Kryetari i Komisionit Qeveritar të Kosovës për Personat e Zhdukur, Andin Hoti, i ka nisur një letër kryediplomates së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, duke kërkuar hapa konkretë prej saj dhe bllokut evropian për ta detyruar Serbinë që të bashkëpunojë dhe t'i hapë arkivat e saj shtetërore, përfshirë ushtarake, policore dhe të inteligjencës, për ta kuptuar vendndodhjen e të zhdukurve të luftës së fundit në Kosovë më 1998/99.

Në "Facebook", Hoti ka bërë me dije se delegacioni i Kosovës, përveç hapjes së arkivave, ka kërkuar edhe bashkëpunim të plotë për "zbardhjen e rolit të forcave paramilitare dhe bashkëpunëtorëve serbë, të cilët, me mbështetjen e regjimit të [Sllobodan] Millosheviqit, ekzekutuan dhe zhdukën mijëra shqiptarë", si dhe "llogaridhënie për refuzimin e vazhdueshëm të Serbisë për të dorëzuar informacion mbi varrezat masive të njohura brenda territorit të saj".

Hoti e ka bërë me dije këtë kërkesë drejtuar Kallasit në ditën e shënimit të 17-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. "Pavarësia jonë është arritur me sakrificat të



mëdha dhe ne nuk mund të lejojmë që viktimat e gjenocidit të harrohen apo të mohohet e drejta e familjeve për ta ditur të vërtetën. Serbia vazhdon ta mohojë përgjegjësinë e saj dhe t'i sabotojë përpjekjet për drejtësi, duke refuzuar t'i zbulojë të dhënat mbi vendndodhjen e të zhdukurve", ka thënë Hoti.

Edhe në ceremonitë e mbajtura gjatë ditës nga krerë të lartë shtetërorë, përfshirë presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti, janë nderuar "të gjithë ata që u sakrifkuan dhe u flijuan" për lirinë. Më 15 janar të këtij viti ishte planifikuar mbajtja e një takimi të Komisionit të përbashkët të Kosovës dhe të

Serbisë për të pagjeturit, mirëpo ai ka dështuar për shkak të refuzimit të Serbisë për të marrë pjesë, si shenjë proteste pas një aksioni të Qeverisë së Kosovës për mbylljen e institucioneve të Serbisë. Komisioni i përbashkët Kosovë - Serbi për të pagjeturit është ngritur në bazë të një marrëveshjeje të

arritur vitin e kaluar në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve mes dy vendeve, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur.

Sipas Kryqit të Kuq, në Kosovë janë ende 1 612 persona të pagjetur nga lufta.

Formimit të Komisionit i ka paraparirë pajtueshmëria e arritur nga udhëheqës të Kosovës dhe Serbisë më 2023 për Deklaratën e përbashkët për Personat e Zhdukur.

Disa prej zotimeve të bëra në deklaratë përfshijnë: qasje të plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënie në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe punë të përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian.

Në praktikë nuk është realizuar asnjëra pikë e deklaratës pavarësisht prej thirrjeve të bllokut evropian. Kosova dhe Serbia bisedojnë që prej vitit 2011 dhe kanë arritur edhe një mori marrëveshesh të tjera, por jo të gjitha janë zbatuar.

Bashkimi Evropian ua rikujton dy palëve se avancimi në procesin e dialogut është i lidhur me rrugën e tyre në integritet euroatlantike.

## Edita Tahiri: Shqetësuese pozita e Kosovës dhe Shqipërisë në raport me ShBA-në

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialog me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se Konferenca e Munihut për Siguri la në margjina Ramën dhe Kurtin, nuk arritën të takohen me zëvendës-presidentin amerikan JD Vance, i cili në fjalimin e tij bëri me dije se liderë autokrat që shtypin opozitën e arrestojnë kundërshtarët politikë cenojnë vlerat e përbashkëta demokratike. Është shumë shqetësuese pozita e dy shteteve tona

duhet të kenë liderë demokratë dhe jo autokratë. "Konferenca e Munihut për Siguri la në margjina Ramën dhe Kurtin, nuk arritën të takohen me zëvendës-presidentin amerikan JD Vance, i cili në fjalimin e tij bëri me dije se liderë autokrat që shtypin opozitën e arrestojnë kundërshtarët politikë cenojnë vlerat e përbashkëta demokratike. Është shumë shqetësuese pozita e dy shteteve tona

në raport me ShBA-në, ardhja e presidentit Trump është porosi se shtetet tona duhet të kenë liderë demokrat dhe jo autokrat - por një gjë e mirë ndodhi në Munihi sepse Rama e Kurti i buzëqeshën njëri-tjetrit kur u takuan, pas një kohe të gjatë të buzëqeshjes së ngrirë që patën mes vete. Me gjasë mërzia e dobësisimit politik e të dyve i afroi", ka shkruar Tahiri.







# Pas zgjedhjeve aktivizohen ambasadorët e Quintit

Ambasadorët nga disa shtete të Quintit dhe i dërguari evropian në Kosovë kanë zhvilluar të hënën takime të ndara me liderët e partive politike në Kosovë. Temë e diskutimeve kanë qenë hapat e ardhshëm pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Mesazhi i ambasadorëve të huaj ishte se qeveria e re duhet t'i ndjekë reformat për t'iu bashkuar BE-së. Ndërkaq liderët politikë kanë theksuar se presin që Komisioni Qendror Zgjedhor ta mbyllë sa më shpejt procesin e numërimit dhe certifikimit të rezultateve

**EPOKA E RE**

## Mal QORRAJ

Prishtinë, 18 shkurt - Ambasadorët nga disa shtete të Quintit dhe i dërguari evropian në Kosovë kanë zhvilluar të hënën takime të ndara me krerët e partive politike në Kosovë me të cilët kanë diskutuar për hapat e ardhshëm pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Në Quint bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia dhe Franca.

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, ka zhvilluar takime të ndara me kreun e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, me atë të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, me

udhëheqësin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, dhe me kreun e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. "Theksova se shumica e popullit në Kosovë aspiron t'i bashkohet BE-së. Qeveria e re duhet t'i ndjekë në mënyrë aktive reformat në mënyrë që të arrihen", ka shkruar ai në platformën "X", pas takimeve me krerët partiakë.

Lidhur me takimin me ambasadorin Orav, Kryeministria ka njoftuar se Kurti ka biseduar me zyrtarin evropian për hapat e mëtejshëm drejt konstitutimit të Kuvendit dhe formimit të qeverisë së re. "Gjatë takimit ambasadori Orav vlerësoi pozitivisht procesin zgjedhor të 9 shkurtit, duke e cilësuar të rregullt dhe

pa incidente dhe theksoi se pozitivisht është vlerësuar edhe nga Brukseli", u tha në njoftimin për medie.

Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, po ashtu është takuar me ambasadorin francez Olivier Guerot dhe atë Mbretërisë së Bashkuar, Jonathan Hargreaves. "PDK-ja e konsideron votën shprehje të pjekurisë politike dhe mbështet formimin sa më të shpejtë të një qeverie funksionale dhe të përgjegjshme. Pavarësisht prej pozicionit tonë politik, interesi i Kosovës dhe i qytetarëve mbetet udhërrëfyesi ynë kryesor përpara", ka shkruar Krasniqi në "Facebook" pas takimit me ambasadorin francez.

Ndërkaq, LDK-ja tha se Abdixhiku dhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Orav, diskutuan për qëndrimet e këtij subjekti sa i përket procesit zgjedhor. "Kryetari Abdixhiku theksoi se LDK-ja e respekton plotësisht vullnetin qytetar të shprehur gjatë këtij procesi zgjedhor dhe, po ashtu, pret që Komisioni Qendror Zgjedhor ta mbyllë sa më shpejt procesin e numërimit dhe certifikimit të rezultateve, duke theksuar se është shumë e rëndësishme që ky proces të përfundojë në mënyrë demokratike dhe duke shmangur çdo vonesë tjetër", u tha në njoftimin e LDK-së.

E ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane në

Prishtinë, Anu Prattipati, është takuar me kreun e AAK-së, Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar për procesin zgjedhor, zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe për partneritetin mes dy shteteve. "Shpreha mirënjohjen time të thellë për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja i ka dhënë Kosovës ndër vite. Ky partneritet i fuqishëm përbën garancinë më të mirë për të ardhmen e sigurt të Kosovës dhe stabilitetin afatgjatë të rajonit", ka shkruar Haradinaj në "Facebook", pas takimit me Prattipatin.

Edhe kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Në këtë takim kryesuesi Radoniqi e informoi ambasadorin Hargreaves lidhur me aktivitetet që aktualisht është duke i zhvilluar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Radoniqi e njoftoi ambasadorin britanik se KQZ-ja në Qendrat Komunale të Numërimit është duke bërë numërimin e votave të kandidatëve për deputetë dhe se në pjesën më të madhe të komunave ky proces ka përfunduar. Gjithashtu, Radoniqi e informoi ambasadorin britanik edhe për proceset e tjera që po kryhen nga KQZ-ja, siç është vlerësimi i pakove me fletëvotime nga votimi jashtë Kosovës,

respektivisht votimi përmes postës.

Nga ana e tij, ambasadori Hargreaves e përgëzoi KQZ-në për procesin e suksesshëm dhe të qetë të 9 shkurtit si dhe vlerësoi përpjekjet e KQZ-së që procesi në vazhdim të realizohet sa më shpejt dhe me transparencë.

Në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, sipas rezultateve preliminare, LV-ja ka dalë e para me 40.84 për qind të votave, pasuar nga PDK-ja me 22.5 për qind, LDK-ja me 17.67 për qind dhe koalicioni AAK-Nisma me 7.45 për qind.

Asnjëra parti nuk i ka siguruar votat e nevojshme për ta formuar qeverinë, pasi nevojiten votat e 61 deputetëve në Kuvendin prej 120 ulësesh, prandaj njohësit e çështjeve politike kanë paralajmëruar se Kosova mund të përballet me turbulenca politike në ditët dhe javët në vijim.

Partitë opozitare, PDK-ja dhe AAK-ja, kanë thënë se pëlqejnë të bashkëpunojnë me partitë që aktualisht janë në opozitë për ta formuar ekzekutivin e ri, ndërkaq LDK-ja ka thënë se pret numërimin përfundimtar të votave për t'i ofruar qëndrimet e veta politike.

Aktualisht janë duke u numëruar votat për kandidatët për deputetë, ndërkaq më pas pritet të numërohen votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe votat nga diaspora.



# QEVERIA E HAJNAVE!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Festa e Pavarësisë, pa hijeshi:** Dje u festua Dita e Pavarësisë ku, në rolin kryesor, për fat të keq ishin ata që nuk bënë as sakrificën më të vogël për pavarësi, as personalisht e as familjarisht. Ata që lanë asht dhe rrashtë për pavarësi, ose kanë kaluar në amshim ose janë në burg të Hagës si pengje të kriminelëve juridik dhe politik ndërkombëtar dhe bartësve të organizimit të kësaj feste që bujarisht, duke dërguar dosje të sajura ose duke dëshmuar si dëshmitarë të mbrojtur, nuk e kam të qartë nga kush të mbrohem kontribuuan që krijuesit e pavarësisë të mbahen të burgosur duke i rënë "gurit dhe drurit" që ata të mos lirohen. Mundësisht të mos kthehen kurrë! Ata shkuan te varri i Ibrahim Rugovës për të përfutur politikisht jo se kishin ndonjë respekt për te. Pastaj, kinse për respekt vizituan edhe vendamshimin e Bacë Adem Demaçit, Abetares dhe Akademisë së Luftës dhe Sakrificës për Liri dhe Bashkim Kombëtar. Respektin më të madh do ia bënin nëse nuk do të shkonin fare te vendamshimi i Bacë Adem Demaçit. E vazhduan rrugëtimin e hipokrizisë dhe përfutur politik duke blasfemuar vendin e Shenjtë të çdo patrioti shqiptar,

Kryeqytetin e Lirisë dhe Pavarësisë, Prekazin e Komandantit Legjendar Adem Jashari. Pse po e them se janë hipokritë dhe, jo me dy fytyra si Janusi por me shumë fytyra të pafytyra. Të quash çlirimtarët mercenarë, të punosh kundër veteranëve të luftës dhe të koordinohesh me "aktivistin" Milan Radojiçiq, është më se e mjaftueshme, për një popull dhe qytetari liridashëse, që këto stërkeqe kombëtare të shpallen non grata. Presidentja Osmani nuk e ka asnjë nëngjen e lëre më gjen në zinxhirin gjenetik që e ndërlidhë me luftën çlirimtare apo me përcaktim kombëtar që ndërlidhet me luftën. Manipulon paturpësisht me Rugovën, për nevoja dhe qëllime të përfutur politik. Dha dhjetëra mijëra euro të taksave të qytetarëve të Kosovës kinse me e riparuar veturën e Ibrahim Rugovës pas atentatit, asnjëherë të zbuluar, në vend se ta lërë në gjendje që ishte, si eksponent muzeal. Po qëllimin e kishte që për këtë festë t'i shëtite të pasmet duke parakaluar si Imelda Markos e jo se kishte apo ka ndonjë respekt për Ibrahim Rugovën. KM teknik., Albin Kurti, me gjysmë zëri e përmendi emrin e Hashim Thaçit, jo lexuesit të Deklaratës së Pavarësisë por krijuesit dhe arkitektit të

Pavarësisë së Kosovës, bashkë me bashkëlufëtarët e tij politik dhe ushtarak. Hashim Thaçi është vet historia e luftës për liri, çlirim dhe pavarësi, u pëlqeu apo jo pjellës serbe dhe jugosllave që ka metastazuar në shumë segmente institucionale. Këta nuk e duan Hashim Thaçin, Bacë Adem Demaçin, Adem Jasharin dhe çlirimtarët e vërtetë. Këta e përdhunuan edhe vet Hasan Prishtinën duke e përjashtuar nga Universiteti i Prishtinës. Këta pastaj e organizojnë Festën e Pavarësisë!!!!

**Hajdutë të çdo gjëje:** Duan t'i vjedhin meritat, vuajtjet, luftën e pabërë, shtetin e mohuar dhe të dhunuar nga vet ata, votat vendore dhe të diasporës, duan ta vjedhin historinë përmes rishkrimit të saj. Për këtë e urrejnë aq shumë Hashim Thaçin, i urrejnë mercenarët çlirimtarë, e duan natën Radojiçiqin ndërsa e shajnë ditën. E urrejnë Ali Ahmetin ndërsa e duan Bekim Koçen. I përndjekin patriotët, bashkëjetojnë me jopatriotët me të cilët e kanë të njëjtën grup të gjakut. Thërrasin për luftë, i frikësohen edhe paqes. Vetëm për pushtet, pa shtet. Dje ishte një foto e Albin B(P)apës me Bacën Adem

Demaçi me porosi lustruese për figurën dhe personalitetin, si njeri i besueshëm i Bacës, dorë e djathtë e tij. Njëqind për qind kam qenë pjesë e atij procesi të lirimit të një udbashi serb, Albini kishte rol teknik, asgjë më tepër. Po, le ta hyjnizojnë, e kanë mundësin por jo edhe të drejtën. Pavarësisht kësaj kemi të bëjmë me dy realitete përjashtuese ndaj njëra tjetrës: Hashim Thaçi është Ati Themeltar i Pavarësisë dhe shtetit të Kosovës kurse Albin Kurti është Baba i kopesë politike që i shkon pas!!

**Kush e formon qeverinë:** Po të vendosja unë qeveria do të formohej lehtë dhe shpejtë... nga LV. I kanë fituar zgjedhjet, e duan pushtetin, janë mashtrues dhe të paskrupullt andaj duhet të përballen me pasojat. Duhet ta korrin atë që e kanë mbjell! Shihemi shpejt dhe vjen koha e të korrurave. Opozita duhet të rri anash, mos të pengojë me asgjë formimin e qeverisë Kurti VV. Është kohë e keqe për çdo qeveri, askush nuk na pyet për asgjë. Merreni me mend Trump dhe Putin e përjashtuan Evropën nga bisedimet me Ukrainën, nuk e pyesin për asgjë. Në vend se shtetet evropiane të jenë pjesë e tavolinës për bisedime, ato do

të jenë pjesë e menysë që pamëshirshëm do të hahen dhe gëlltiten nga kanibalët politikë, Trump dhe Putin. Albin Kurti dhe Kosova nuk do të jenë as në listën e menysë, madje as si peçurkat e Akademik Bahtirit. Opozita ka nevojë të reformohet duke e profilizuar qëndrueshmërinë dhe vazhdueshmërinë e lidershipit. Nëse hyjnë në koalicion me LV-në, do të rrëzohen për toke, nëse pranojnë të qeverisin do të përfundojnë në pjatat e Rubios, Lavrovit dhe Vuçiqit. Kosovën nuk e presin ditë të mira, madje edhe netët do të jenë me ankth. Na dribloi Vuçiqi deri në kohën e rikthimit të Trumpit në pushtet. Ky edhe ishte qëllimi i Vuçiqit dhe injoranca kapitale e Kurtit. Lëshuam shumë raste, luajtëm sipas ritmit politik të Vuçiqit. Rrafsh tre vite është trumpetuar se në Kosovë do të ketë luftë, do të sulmohemi nga Serbia. Në ballë të mbrojtjes e kemi komandant Pasulin. Madje, në një media pashë një grupim të LV-së që i kishte rënë pjatave të pasulit. Poshtë shkruhej se këta e hanë pasulin kokërr - kokërr. Nuk e besoj. Mendoj se e hanë pasulin me e rritë intensitetin e pordhave, me i bë më të zhurmshme, kishin mbetur pa zë fare.

## Misioni i ShBA-së në NATO: Përpjekja e ushtarëve tanë vazhdon për një mjedis të sigurt në Kosovë



Prishtinë, 18 shkurt - Misioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në NATO i ka kushtuar vëmendje përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Në faqen e vet zyrtare në platformën X ka shkruar se kjo javë shënon 17-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, një dëshmi e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë së popullit të Kosovës. Misioni amerikan në

Aleancën Veri-Atlantike ka shkruar dhe publikuar foto se përpjekjet e tij vazhdojnë për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. "Kjo javë shënon 17-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, një dëshmi e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë së popullit të Kosovës. Ne, gjithashtu, shprehim mirënjohjen tonë të përzemërt për ShBA-në

dhe forcat aleate për punën e tyre të paçmuar përmes misionit të KFOR-it, një operacion për mbështetjen e paqes i nisur në vitin 1999. Përpjekjet e tyre vazhdojnë të sigurojnë një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë", thuhet në njoftim. Kosova një ditë më parë ka shënuar 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës e cila u shpall më 17 shkurt 2008.



# SULMET SISTEMATIKE NGA SERBIA GJATË LUFTËS NË KOSOVË DHE PLANI 'PATKOI'



Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

## 1. Hyrje - Lufta në Kosovë dhe strategjia e spastrimit etnik

Lufta në Kosovë (1998-1999) u karakterizua nga një fushatë e organizuar e spastrimit etnik të kryer nga regjimi serb i Sllobodan Millosheviqit. Kjo fushatë synonte dëbimin e shqiptarëve përmes masakrave, djegies së fshatrave dhe shkatërrimit të infrastrukturës civile. Në këtë kuadër, plani "Patkoi" ishte një strategji ushtarake e hartuar nga Ministria e Brendshme dhe Ushtria Jugosllave për të kryer pastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës. Ky plan u zbulua nga shërbimet sekrete gjermane dhe u prezantua para komunitetit ndërkombëtar si një provë e politikës shtetërore të Serbisë për gjenocid në Kosovë.

## 2. Strategjia e planit "Patkoi"

Plani "Patkoi" përbëhej nga disa faza të qarta: 1. Rrethimi dhe goditja e zonave shqiptare - Fshatrat dhe qytetet shqiptare do të rrethoheshin, do të sulmoheshin nga artileria dhe njësitë speciale serbe do të kryenin vrasje masive. 2. Dëbimi me forcë i popullsisë shqiptare - Banorët do të nxirreshin nga shtëpitë e tyre, do të urdhëroheshin të largoheshin drejt kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë etj. 3. Shkatërrimi i pronave dhe infrastrukturës shqiptare - Shtëpitë, shkollat, xhamitë dhe spitalet do të digjeshin për të pamundësuar kthimin e shqiptarëve. 4. Eliminimi i intelektualëve dhe liderëve

shqiptarë - Njësitë paramilitare serbe do të ekzekutonin mësues, doktorë, gazetarë dhe aktivistë shqiptarë për të shkatërruar bazën sociale të rezistencës. 5. Ndryshimi i strukturës demografike - Pasi shqiptarët të dëboheshin, Serbia do të kolonizonte zonat e spastruara me serbë të ardhur nga Bosnja dhe Kroacia.

## 3. Masakrat dhe krimet e Serbisë gjatë zbatimit të planit "Patkoi"

Gjatë vitit 1998-1999, Serbia zbatoi një politikë sistematike të masakrave dhe terrorit ndaj popullsisë shqiptare. Disa nga rastet më të rënda janë: 3.1 Masakra e Reçakut - 15 janar 1999. Në mëngjesin e 15 janarit 1999, forcat speciale serbe rrethuan fshatin Reçak në komunën e Shtimes. Pas disa orësh granatimesh, njësitë paramilitare hynë në fshat, hynë në shtëpi dhe nxorën civilët jashtë. 45 shqiptarë, përfshirë burra, gra dhe fëmijë, u ekzekutuan në mënyrë brutale. Kjo masakër u dëshmuar nga ambasadori i OSBE-së, William Walker, i cili e cilësoi si "krim kundër njerëzimit".

3.2 Masakra e Prekazit 5-7 mars 1998. Një nga operacionet më brutale të forcave serbe u zhvillua në Prekaz, kundër familjes së komandantit të UÇK-së, Adem Jashari. Pas një sulmi tre-ditor, forcat serbe vranë 58 anëtarë të familjes Jashari, përfshirë gra dhe fëmijë. Ky akt ishte një nga shembujt më të qartë të synimit serb për të shkatërruar çdo bërthamë të rezistencës shqiptare.

3.3 Masakra e Krushës së Madhe 25-26 mars 1999. Njësitë paramilitare serbe hynë në Krushë të Madhe dhe mblodhën burrat shqiptarë në një hambar. Më shumë se 240 burra u ekzekutuan dhe u dogjën në vend. Gratë dhe fëmijët u detyruan të iknin, ndërsa fshati u dogj plotësisht.

3.4 Masakra e Izbicës - 28 mars 1999. Në Izbicë të Skenderajt, forcat serbe ekzekutuan 147 civilë shqiptarë në një fushë të hapur. Trupat e tyre u varrosën në varre masive dhe më vonë u zhvendosën në Serbi për të fshehur gjurmët e krimit.

3.5 Masakra e Mejës - 27 prill 1999. Forcat serbe vranë 377 burra dhe djem shqiptarë në komunën e Gjakovës. Viktimat u ndanë nga familjet e tyre dhe u ekzekutuan në grupe. Më

vonë, trupat e tyre u gjetën në varreza masive në Batajnicë, afër Beogradit.

3.6 Masakra e Podujevës - 28 mars 1999. Njësitë paramilitare serbe "Shkorpionët" ekzekutoi 14 gra dhe fëmijë shqiptarë në Podujevë. Viktimat ishin kryesisht fëmijë të moshës 5-12 vjeç.

## 4. Pastrimi etnik dhe deportimi masiv i shqiptarëve

Mbi 1 milion shqiptarë u dëbuan nga Kosova drejt Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Forcat serbe detyronin shqiptarët të largoheshin nga shtëpitë e tyre duke përdorur dhunë, rrahje dhe kërcënime me vdekje. Gjatë dëbimeve, shumë shqiptarë u ekzekutuan në kolonat e refugjatëve, siç ndodhi në masakrën e Suharekës ku 49 civilë u vranë brenda një kamioni frigoriferik..

## 5. Zbulimi i varrezave masive në Serbi

Pas luftës, hetimet ndërkombëtare zbuluan se Serbia kishte zhvendosur trupat

e civilëve shqiptarë në varreza masive për të fshehur krimet. Disa prej lokacioneve kryesore janë: Batajnica - mbi 744 trupa të shqiptarëve të Kosovës u gjetën në një bazë policore pranë Beogradit. Petrovo Selo - mbi 60 trupa u gjetën në këtë zonë të fshehur nga autoritetet serbe. Rudnica - varrezë masive e zbuluar në jug të Serbisë me dhjetëra trupa të shqiptarëve të Kosovës.

## 6. Ndërhyrja e NATO-s dhe fundi i spastrimit etnik

Përballë këtyre krimeve, NATO nisi një fushatë ajrore 78-ditore kundër Serbisë më 24 mars 1999. Kjo çoi në tërheqjen e forcave serbe nga Kosova më 10 qershor 1999. Pas luftës, Serbia u detyrua të pranonte misionet ndërkombëtare në Kosovë, ndërsa Kosova filloi procesin e shtetformimit. Plani "Patkoi" dhe krimet serbe në Kosovë përbëjnë një nga rastet më të qarta të gjenocidit në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Përpjekjet për të sjellë drejtësi për viktimat vazhdojnë, ndërsa Kosova ruan kujtimin e këtyre krimeve si pjesë e historisë së saj tragjike.



## Gjatë vitit 2024 mbi 193 mijë pacientë kanë marrë shërbime radiologjike

PRISHTINË, 18 SHKURT - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se gjatë vitit 2024 mbi 193 mijë pacientë kanë marrë shërbime radiologjike në kuadër të Klinikës së

Radiologjisë në QKUK. Nga numri i përgjithshëm i pacientëve, 110 mijë radiografi, mbi 36 mijë tomografi të kompjuterizuara (ct), 12 mijë e 315 rezonanca magnetike, 2

mijë 500 mamografi, 31 mijë e 334 ultrazë, 2 mijë tomografi të kompjuterizuara-angiografi, 78 angiografi-dsa, 1343 bioosu dhe 21 pacientë në Stroke Center.

Bazuar në raportin e Klinikës së Klinikës së Radiologjisë, lista e pritjes për rezonancë magnetike është deri më 3 prill, kurse për CT deri më 10 mars 2024.





## Lladrovci: Nga 11 kandidatët e komunës sonë, presim që gjysma prej tyre të bëhen deputetë

DRENAS, 18 SHKURT - Kryetari i Degës së PDK-së në Drenas, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se numërimi i votave në Drenas ka përfunduar. Ai ka thënë se si asnjë herë më parë, mbi 19 mijë vota i mori PDK-ja në Drenas. "Vota këto që dëshmuam fuqinë tonë elektorale në bastion, me kandidatët e njohur për qytetarët si dhe punën e palodhshme të Shtabit zgjedhor dhe nënshtabeve në

teren. Me angazhimin e palodhshëm, dëshmuam se mundemi ma mirë dhe mundemi ma shumë. Dëshmuam se qytetarët tanë janë kampion nga komuna kampion. Nga 11 kandidatët e komunës tonë, presim që gjysma prej tyre të bëhen deputetë e ardhshëm. Ju uroj sukses dhe pres të japin kontribut për komunën e Drenasit", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".



Ai ka thënë se zgjedhjet ishin të suksesshme, transparente dhe në pajtim me ligjin. "Fushata kishte rrjedhë të qetë dhe

konform të gjitha standardeve pa asnjë vërejtje as dënim. Të gjitha takimet, 44 prej tyre u zhvilluan me kohë dhe sipas planit, me pjesëmarrjen e rreth 10 mijë qytetarëve, për këtë i falënderoj të gjithë qytetarët, anëtarët dhe simpatizantët e PDK-së, anëtarët e Shtabit zgjedhor të degës, shefat e nënshtabeve dhe kandidatët për deputetë", ka thënë ai. Lladrovci ka thënë se është krenar me qytetarët e

komunës së Drenasit dhe punën e shkëlqyer për zgjedhje të lira dhe demokratike. "Përgëzoj qytetarët të Drenasit për fushatën dhe procesin e suksesshëm zgjedhor. Deputetëve të ardhshëm, ju uroj të jenë përfaqësues sa më meritore për bastionin e PDK-së, Drenasin, gjashtë herë kampion të qeverisjes së mirë! Kosova mundet ma mirë!", ka shkruar Lladrovci.

## VITI 2025 NIS ME RITJE ÇMIMESH NË KOSOVË, INFLACIONI NË JANAR 1.5 %

PRISHTINË, 18 SHKURT - Viti 2025 ka filluar me lajme jo të mira për qytetarët e Kosovës. Inflacioni në janar është rritur mesatarisht 1.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni mujor i matur ishte 0,7 për qind, ndërsa norma vjetore e inflacionit arriti në 1,5 për qind krahasuar me janarin e vitit 2024. Rritja e çmimeve është ndikuar kryesisht nga disa kategori kryesore të konsumit, raporton monitor.al. Në krahasim me dhjetorin 2024, çmimet janë rritur më së shumti te perimet, energjia elektrike, duhani, karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal, kafeja, çaji dhe kakao, si dhe produktet e tjera ushqimore si mishi dhe pemët. Në krahasim me janarin

e vitit të kaluar, çmimet janë rritur ndjeshëm për disa kategori të mallrave dhe shërbimeve. Ndër produktet dhe shërbimet me rritjen më të lartë të çmimeve janë kafeja, çaji dhe kakao, vajrat dhe yndyrat, si dhe shërbimet për transportin personal. Po ashtu, çmime më të larta janë regjistruar për pijet joalkoolike, gazetatat dhe materialet për zyra, shërbimet financiare, mishi dhe produktet e qumështit. Kafja, çaji dhe kakao 14.6%. Vajrat dhe yndyrat 8.3%. Shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit 7.6%. Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet 6.1%. Gazetat, librat dhe materialet për zyra 5.4%. Shërbimet financiare 5.2%. Qelqurinat, takëmet dhe



mjetet e kuzhinës 5.1%. Mish 4.6%. Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake 4%. Pijet alkoolike 3.9%. Qumështi, djathi dhe vezët 3%. Veshjet 2.9%. Duhani 2.9%. Perimet 2.5%. Kujdesi personal 2.5%. Buka dhe drithërat 2.1%. Shërbimet hoteliere 2.1%. Që nga viti 2021 inflacioni në Kosovë ka ndjekur

një trajektore rritëse eksponenciale, duke arritur kulmin me një normë vjetore prej 11.58% në vitin 2022. Në vitin 2024, 44 për qind e familjeve raportuan se blejnë më pak produkte, ndërsa shpenzojnë më shumë, sipas një ankete të publikuar nga UNDP në shkurt 2024. Ndërsa çmimet e produkteve

kërcënonin mirëqenien e familjeve me të ardhura të ulëta, qeveria Kurti u akuzua për indiferencë ndaj krizës. Nga ana tjetër, pretendimet e përsëritura të Kurtit se Kosova zbatoi pakon më të madhe mbështetëse në rajon në raport me BPV-në pati efekte minimale në zbutjen e krizës, sipas raporteve ndërkombëtare. Vlerësimi i Bankës Botërore për vitin 2022 pikturoi një pamje të zymtë të skemave të asistencës sociale të Kosovës, duke i përshkruar ato si "të ngurta" dhe kryesisht joefektive në adresimin e krizës. "Pavarësisht prej niveleve të larta të shpenzimeve për mbrojtjen sociale, skema e ndihmës sociale është e ngurtë dhe mund të ofrojë vetëm mbrojtje të kufizuar".

## GJERMANIA AKUZON SERBINË PËR NDËRHYRJE NË ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

PRISHTINË, 18 SHKURT - Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se Serbia ka ndërhyrë në zgjedhjet e rregullta parlamentare në Kosovë të mbajtura më 9 shkurt, duke kërkuar vota për Listën Serbe. Rohde shkroi në rrjetet sociale se për ndërhyrjen e Serbisë në zgjedhjet e 9 shkurtit ka folur edhe shefja e misionit të Bashkimit Evropian për monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, Nathalie Loiseau. Më 11 shkurt, në prezantimin e gjetjeve preliminare të këtij misioni të BE-së, u tha se Serbia

kishte ndërhyrë në zgjedhje përmes trysnisë ndaj votuesve serbë në Kosovë. Sipas rezultateve preliminare, Lista Serbe - parti që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - ka fituar 4.55 për qind të votave të rregullta. Ende është e paqartë se sa vende në Kuvendin e Kosovës do të marrë kjo parti nga dhjetë vendet e garantuara për komunitetin serb, teksa ende nuk janë numëruar votat me kusht, ato të personave me nevoja të veçanta dhe votat nga jashtë. Serbia kishte ofruar transport



për serbët që të shkonin në Kosovë për të votuar më 9

shkurt. Pas votimeve, Lista Serbe ka pretenduar se ka fituar

të dhjetë vendet e garantuara. Reagimi i Rohdes vjen pasi një ditë më herët Zyra për Jashtë e Gjermanisë shprehu shqetësimin lidhur me situatën në Serbi ku, sipas Berlinit zyrtar, aktivistët atje po përballen me sulme dhe fushata shpifjeje. Rohde tha se "këto sulme dhe fushata kalojnë kufijtë serbë. Siç ka theksuar Loiseau, Serbia ka ndërhyrë në zgjedhjet e Kosovës duke kërkuar vota për Listën Serbe. Në të njëjtën kohë, Serbia pa bazë po e akuzon Kosovën se po mbështet protestat në Serbia, pa ofruar asnjë provë".

## Bislimi në Varshavë përmend KQZ-në: Kosova ka përjetuar sulme hibride gjatë zgjedhjeve të 9 shkurtit

PRISHTINË, 18 SHKURT - Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka marrë pjesë në takimin e ministrave për çështje evropiane në Varshavë, i cili u organizua nga Presidenca e Polonisë e Këshillit të BE-së. Bislimi ka njoftuar se temë diskutimi do të jenë kërcënimet e sulmeve hibride ndaj procesit



të zgjerimit të BE-së dhe përballimi në mënyrë të

përbashkët i sfidave që paraqiten. Ai ka mbajtur një konferencë para këtij takimi, në të cilën ka përmendur sulmet që ndodhën në faqen e KQZ-së në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt. "Ne patëm zgjedhje në Kosovë javën e kaluar dhe e përjetuam drejtpërdrejt këtë formë të kërcënimeve të

sigurisë për sa iu përket sulmeve në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por edhe në një frekuencë shumë të sofistikuar dhe intensive të shpërndarjes dhe prodhimit të informacioneve të rreme, shumë të sofistikuar për sa iu përket çështjeve dhe kohës së

përzgjedhur", ka thënë Bislimi. Bislimi ka theksuar se vendet tona mund ta ndryshojnë frekuencën dhe intensitetin e këtyre kërcënimeve, prandaj, sipas tij, zgjedhja e duhur është që të gjithë së bashku të diskutojmë për përgjigjen e mundshme ndaj këtyre kërcënimeve të sigurisë.



## Bizneset kërkojnë heqjen e tarifës për pagesat elektronike me POS

PRISHTINË, 18 SHKURT - Pagesat elektronike janë të pëlqyera më shumë se ato me para të gatshme, por për secilën shumë të paguar nga konsumatorët me kartelë bankare në dyqane, deri në 3 për qind të asaj shume u ndalen bizneseve nga bankat komerciale.

Bizneset kanë kërkuar vazhdimisht heqjen e tarifave për këto shërbime me POS, por kjo kërkesë nuk po përmbushet nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Bizneset, veçanërisht ato që ofrojnë shërbime me kartela bankare, këtë kosto e konsiderojnë si një barrë të madhe për ta.


Nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) thonë se tarifën për shërbimet e pranimit të pagesave elektronike janë të domosdoshme për mbulimin e kostove të pajisjeve,

mirëmbajtjes, dhe proceseve të tjera të lidhura me pagesat. Sipas BQK-së, tarifën janë të përcaktuara nga rregullat e Bashkimit Evropian dhe janë të kufizuara në 0.2 për qind për kartelat e debitit dhe 0.3 për qind për kartelat e kreditit.

Kërkesën për heqjen e kësaj tarife e ka bërë edhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës (DHTIK).

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Skënder Krasniqi, thotë se kjo tarifë ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së produkteve dhe shërbimeve, duke shkaktuar kështu, sipas tij, një rritje të informalitetit duke i detyruar bizneset t'i shmangin pagesat elektronike në favor të transaksioneve me para të gatshme.

Nëse një biznes ka pagesa me kartela bankare deri në 10



mijë euro, mund të humbasë deri në 300 euro vetëm nga tarifën për këto transaksione, sipas Krasniqit.

Ndërkaq, menaxheri i

përgjithshëm në kompaninë "Elkos", Arsim Selmonmusaj, deklaron se kjo tarifë për pagesat elektronike është një barrë shtesë për bizneset,

duke rritur, sipas tij, kostot e secilit produkt.

Ndërsa Krasniqi vazhdon të insistojë se institucionet përgjegjëse duhet ta marrin seriozisht trajtimin e kësaj çështje dhe ta heqin këtë tarifë.

Në një përgjigje me shkrim nga BQK-ja thonë se shërbimet e pranimit të pagesave elektronike, përfshirë edhe shërbimin e POS për pranimin me kartela, kanë disa kosto. Me ç'rast, thuhet se BQK-ja me rregullore ka kufizuar tarifën e shkëmbimit të cilat banka që ofron shërbimin e pranimit të pagesave elektronike (në rastin e POS banka/IF që ofron POS) i detyrohet bankës/IF-së lëshuese të kartelave, në 0.2 për qind për kartelat e debitit dhe 0.3 për qind për kartelat e kreditit, në pajtim me rregullat e Bashkimit Evropian (BE).

## GLPS paditë Ministrinë e Financave

PRISHTINË, 18 SHKURT - Me autorizim nga organizatat e shoqërisë civile që e përbëjnë Iniciativën CorrWatch, Qendra për Raste Gjqësore Strategjike ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë padinë deklarative kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) lidhur me mohimin e të drejtës së monitorimit të procesit rekrutues për pozitën e sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie.

Në njoftimin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) thuhet se nga provat që përmban kjo padi, konstatohet se Ministria e Financave ka zhvilluar fazat e rekrutimit për sekretar të përgjithshëm në MFPT sipas konkursit të shpallur më 6 gusht 2024, pa respektuar obligimin ligjor që fazat e rekrutimit të monitorohen



nga shoqëria civile. "Në vend se MFPT të ishte shembull që përmes rolit aktiv të saj t'i ftonte organizatat e shoqërisë civile në monitorimin e fazave të këtij procesi rekrutues, me qëllim të rritjes së transparencës dhe

respektimit të obligimit ligjor që rrjedh nga Ligji për Zyrarët Publik (LZP), ky institucion zgjodhi heshtjen dhe injorimin e kërkesave të vazhdueshme për monitorim të parashtruara nga Iniciativa CorrWatch. Si paditës,

vlerësojmë që mohimi i të drejtës për monitorim të procesit rekrutues paraqet një shembull tipik se si institucionet e administratës publike, në procedurat rekrutuese për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, nuk i zbatojnë në përpikëri rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil që është i aplikueshëm në Kosovë", thuhet në njoftim.

GLPS tutje thekson se një shkelje e tillë nga MFPT-ja mund të krijojë praktika të tilla të paligjshme të cilat mund të ndiqen nga institucionet e tjera publike, me qëllim të shmangies së monitorimit nga shoqëria civile, duke cenuar kështu parimet mbi të cilat bazohet rekrutimi i zyrarëve publikë të përcaktuar në LZP. Përmes kësaj padie gjykatës i është kërkuar ta deklarojë të

drejtën që i njihet nga LZP-ja, që në procedura të rekrutimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në cilësinë e vëzhguesve mund të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe sindikatat. "Po ashtu, ta obligoj MFPT-në dhe të gjitha institucionet publike që të krijojnë kushte dhe ndërmarrin hapa të ligjshëm për të ofruar mundësi që në procedura të rekrutimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në cilësinë e vëzhguesve të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe sindikatat. Qendra për Raste Gjqësore Strategjike mbetet e përkushtuar që konkurset për pozita të kategorisë së lartë drejtuese të zhvillohen konform legjislacionit në fuqi, duke garantuar transparencë, meritokraci dhe llogaridhënie", thuhet në njoftim.

## Formë e re testimi për patentëshoferë

PRISHTINË, 18 SHKURT - Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit të proceseve administrative, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka njoftuar se ka ndërmarrë disa reforma që do t'i ndihmojnë kandidatët gjatë testimit për marrjen e lejes së vozitjes.


Një nga risitë kryesore që do të implementohet është forma e re e testimit, për të

gjitha kategoritë, që përfshin pyetje të përditësuara dhe një format të ri të testit.

Kështu ka bërë me dije MMPHI-ja në një përgjigje për Telegrafin, ku theksoi se forma e re e testimit të hyjë në fuqi më 18 shkurt, saktësisht sot. "Sot më datë 18.02.2025, në kuadër të risive të proceseve të testimit për kandidatët e patentë shoferëve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

ka ndërmarrë një sërë reformash që synojnë rritjen e transparencës, saktësisë dhe lehtësimin të procesit të testimit për Patentë Shofer", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Infrastrukturës. Ministria ka theksuar se këto risi janë pjesë e angazhimit të tyre për të siguruar një proces më efikas, të drejtë dhe të përshtatshëm për të gjithë kandidatët.

Kujtojmë se kohë më parë kjo ministri kishte hasur në



keqpërdorime e shkelje të shumta ligjore në procesin e marrjes së patentëshoferit. Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen

Durimishi, kishte paralajmëruar se do të konfiskohen të gjitha patentëshoferët që janë marrë kundërligjshëm.



# Na ishte një herë Perëndimi



Lucio CARACCIOLO

## Asgjë nuk është më e sigurt.

As edhe një muaj pas marrjes së detyrës nga Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, këto pesë fjalë përmbledhin thelbin e tronditjes që po ndodh para syve tanë. Përtej propagandës dhe deklaratave publike, revolucioni gjeopolitik tashmë po shfaq krizën ekzistenciale të familjes atlantike, afrimin mes Shteteve të Bashkuara dhe Ruisë, si dhe bashkimin e luftërave në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, të cilat duhen interpretuar brenda të njëjtit ekuacion.

E gjithë kjo ndodh në sfondin e sfidës së vërtetë strategjike globale: përplasjes mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Në të gjitha këto beteja, ne evropianët jemi, në rastin më të mirë, aktorë dytësorë.

## Mbi të gjitha, jemi pa busull.

Samiti i improvizuar mes tetë vendeve atlantike, i thirrur në Paris nga Macron, është njëkohësisht një simptomë e dëshpërimit dhe një sinjal i zbehtë i një përpjekjeje për

rikthim nga “vejushat” e NATO-s së vjetër, të dobësuar nga Trump dhe Putin.

Dhe kjo vjen nga vetëdijësimi i vonuar se, kur loja bëhet e ashpër, strukturat e Bashkimit Evropian nuk e përballojnë dot konkurrencën.

Takimi mes shtatë vendeve të BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, e cila tashmë është vënë në shënjestër nga “aleati vëllazëror” me flamurin me yje dhe shirita, për të përballuar emergjencën e sigurisë në Evropë, shënon lëniën pas të skemave të konsoliduara për tre të katërtat e një shekulli.

Formati i BE-së po skadon njësoj si ai i NATO-s, duke konfirmuar se konstruksioni evropianist ishte një produkt i zgjedhjes atlantike amerikane dhe, për pasojë, nuk funksionon më kur Atlantiku zgjerohet aq shumë sa u imponon partnerëve evropianë, të kërkojnë alternativa ndaj të ashtuquajturës “ombrellë bërthamore” të SHBA.

Përpjekja për të formuar një bërthamë shtetesh evropiane të vendosura për të rindërtuar së bashku themelet e sigurisë sonë kontinentale është pranim i një realiteti dramatik, për shumë kohë të fshehur pas retorikës atlantiste dhe evropianiste.

Por prej ku duhet të rinisemi?

Nëse synohet të ndërtohet një rrugë e përbashkët mes “vendeve kryesore evropiane” (siç i quan Macron), pa pretenduar që formati i Parisit të jetë ekskluziv – ai mund të zgjerohet, por edhe të reduktohet – është e nevojshme të pranohet tre realitete të pakëndshme.

I pari, dhe më i rëndësishmi: në Shtetet e Bashkuara po ndodh një ndryshim i thellë i regjimit që po trondit identitetin, themelet dhe institucionet atje. Elitat amerikane janë të ndara për gjithçka, përveç një gjëje: prioritetit për të penguar parakalimin nga Kina.

Më saktësisht, është e papranueshme që Pekini të kapërcejë Uashingtonin në teknologjitë e reja, duke filluar nga intelijenca artificiale dhe hapësira. Gjithçka tjetër është në funksion të këtij imperativi, duke nisur nga përpjekja për të shpërbërë çiftin e çuditshëm Rusi-Kinë, dy armiq historikë që paradoksalisht janë bashkuar nga Shtetet e Bashkuara, përmes krizës në Ukrainë.

Në këtë rikonfigurim, evropianët janë të parëndësishëm dhe të ndarë mes atyre që do të donin të rifillonin dialogun dhe tregtinë me Federatën Ruse (evropianët e vjetër) dhe atyre që dëshirojnë që Rusia të

zhduket nga faqja e dheut (skandinavët, polakët dhe vendet balltike).

Sa i përket Putinit, interesi i tij është të normalizojë marrëdhëniet me SHBA, për të mos e mbyllur “karrierën” prej autokrati, si një partner i dorës së dytë i Xi Jinping.

I dyti, që lidhet edhe me të parin. Amerikanët dhe rusët janë të interesuar të nxjerrin Izraelin nga kurthi strategjik në të cilin është futur, dhe të krijojnë një ekuilibër të ri në Lindjen e Mesme, në të cilin do të përfshihen turqit dhe sauditët sot, e ndoshta iranianët nesër. Fakti që negociatat e para mes Shteteve të Bashkuara dhe Ruisë për Ukrainën po zhvillohen në Riad simbolizon paralelizmin mes konflikteve në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme. Pra në thelb, nevojën për të zgjeruar kornizën e negociatave përmes një mekanizmi koncesionesh dhe marrëveshjes të ekuilibruara. I treta, dhe më i thelli strukturalisht: Ish-mbrojtësit amerikanë po kërkojnë nga evropianët, që nuk janë më nën mbrojtjen e tyre, sakrifica që nuk jemi në gjendje t'i përballojmë. Nuk është thjesht çështje e shpenzimeve për mbrojtjen, por e papajtueshmërisë mes emergjencave tona të sigurisë dhe mentalitetit të popullsisë,

të cilat prej tre brezash kanë forcuar bindjen se lufta në Evropë ishte zhdukur një herë e përgjithmonë.

Pa përmendur faktin që mosha jonë mesatare është e destinuar të arrijë së shpejti gjysmë shekulli, gjë që përjashton mundësinë që shumica e shoqërive tona të angazhohen në çfarëdolloj fushate ushtarake.

Viktimat kryesore të kësaj situatë janë dhe do të jenë ukrainasit, të cilët, pas tre vitesh rezistence ndaj pushtimit rus, duken të rraskapitur, dhe tashmë zbulojnë se janë braktisur nga amerikanët.

Një tradhëti që sigurisht nuk mund të kompensohet nga evropianët.


Përsëritet për të disatën herë një skenar i njohur, i parashikuar dhe çuditërisht i shpërfillur: amerikanët, të përqendruar në lojërat e tyre të mëdha, tregohen indiferentë ndaj fatit të Kievit, ndërsa evropianët nuk mund ose nuk duan t'i japin veprimeve të tyre peshën e fjalëve.

## Mes paqartësive dhe hipokrizisë.

Na ishte një herë Perëndimi. / La Repubblica – Në shqip nga bota.al



# Perëndimi dhe iluzionet e rrezikshme



Beppe SEVERGNINI

Një ditë dëgjojnë zhurma të çuditshme që vijnë nga dhoma ngjitur – vendosin t'i injorojnë. Në fund të fundit, mund të bëjnë edhe pa atë dhomë. Por zhurmat shtohen, lëvizin edhe në një dhomë tjetër. Pastaj në një tjetër akoma. Në fund, vëllezërit braktisin shtëpinë, të terrorizuar, pa e kuptuar se çfarë ka ndodhur.

Tregimi Casa tomada (Shtëpia e pushtuar) është shkruar në vitin 1946 dhe u botua në një revistë letrare të drejtuar nga Jorge Luis Borges. Autori, Julio Cortázar, ndoshta e shkroi si një reagim ndaj peronizmit, i cili e kishte lënë pa katedër. Por mësimi është i vlefshëm për të gjithë, edhe sot. Nga dembelizmi ose nga plogështia, shpesh zgjedhim të injorojmë sinjalet e përsëritura të alarmit. E dimë që po ndodh diçka e rëndë, por bëjmë sikur nuk shohim

asgjë. Tërhiqemi në atë që na duket një hapësirë e sigurt. Derisa, papritur, ajo pushon së geni e tillë.

Donald Trump, brenda më pak se një muaji, na ka bërë të kuptojmë se çfarë ka në mendje: të shkundë botën dhe të shohë se çfarë ndodh. Përjashtimi i Evropës nga negociatat për Ukrainën është një fyerje ndaj NATO-s. Shpërblimi i agresionit të Putinin do të thotë t'i japë Ruisë rolin e fuqisë dominuese në kontinent. Shkuarja në Mynih dhe tallja me liritë evropiane, siç bëri zëvendëspresidenti J.D. Vance, është fyese. Propozimi për zbrazjen e Gazës për ta kthyer në një resort amerikan me pesë yje është, thjesht, çmenduri.

Perëndimi është shtëpia jonë e përbashkët, dhe Donald Trump po e pushton atë. Por të gjithë – dikush më shumë, dikush më pak – hezitojmë ta pranojmë këtë. Mendojmë se banojmë në një dhomë të largët dhe të sigurt, të

mbrojtur nga ligjet dhe traditat; jemi të bindur se askush nuk do të përpiqet ta thyejë derën. Jemi të sigurt për këtë?

Iluzioni nuk është vetëm evropian. Është, para së gjithash, amerikan. Në SHBA po ndodhin gjëra të rënda: falja e sulmuesve të Kongresit, emërimi i një teoricieni konspirativ kundër vaksinave në krye të shëndetësisë, shkrirja e agjencisë që merret me ndihmat ndërkombëtare, shkarkimi brutal i nëpunësve civilë (njerëz me familje, jo robotë). Mediat e mëdha – me New York Times në krye – denoncojnë, kritikojnë, protestojnë: por nuk japin përshtypjen se e kuptojnë përmasën e ngjarjeve dhe seriozitetin e momentit. Të njëjtën gjë bëjnë shumë qytetarë me prirje demokratike, sidomos ata që jetojnë në dy brigjet: ata mendojnë se janë të sigurt. Po, por deri kur?

Edhe në Itali jemi dëshmitarë

të një spektakli të ngjashëm. Lidhja jonë me SHBA-në nuk është vetëm historike, ushtarake, diplomatike, ekonomike, shkencore, kulturore. Është një lidhje e fortë psikologjike. Për disa është admirim, madje varësi. Për të tjerë habi, e përzier me mosbesim. Por të gjithë jemi të lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e kemi të vështirë të pranojmë se ato janë në rrezik.

Lexohen budallallëqe kolosale, dëgjojnë naivitete të pabesueshme. "Donald Trump është i zgjedhur!", thërrasin shumë. Harrojnë se demokracia nuk do të thotë diktaturë e shumicës. Fitorja në zgjedhje nuk të autorizon të injorosh ligjin kombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare; të ndëshkosh gjyqtarët ose gazetarët; të shpërfillësh shkencën. Të shtunën, në rrjetet sociale, Donald Trump shkroi: "He who saves his Country does not violate any Law" (Ai që shpëton vendin e

tij nuk shkel asnjë ligj). Është një deklaratë e rrezikshme. Por shumë nuk e kuptojnë.


A keni frikë nga Donald Trump? Pak vetë në Itali do t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Pothuajse të gjithë do të mbështeten në atë që, në anglisht, quhet wishful thinking: do të ngatërrojnë gjykimet me dëshirat. Do të thonë se, në fund të fundit, Trump është një negociator i zgjuar, dhe kush e di se çfarë ka në mendje (për Ukrainën, për Rusinë, për Gazën). Se nuk do të përdorë forcën për të marrë Panamanë ose Groenlandën. Se do ta respektojë Kanadanë. Se nuk do të largohet nga NATO-ja. Se oligarkët e teknologjisë, në fund, do ta kthejnë në rrugën e arsyes. A jemi të sigurt?

Të gjithë i dëgjojmë kërcitjet e çuditshme brenda shtëpisë sonë të përbashkët. Por kemi frikë të hapim derën dhe të shohim se çfarë po ndodh. Qëndrojmë në dhomat tona, duke u mashtruar se jemi të sigurt. Deri kur?



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




## Dardanet nisin përgatitjet për Ligën e Kombeve

Prishtinë, 18 shkurt - Kombëtarja e Kosovës e vajzave i ka nisur stërvitjet të martën në Kampin Nacional në Hajvali për dy sfidat e para në edicionin e ri të Ligës së Kombeve në Ligën C. Nën drejtimin e përzgjedhësit Sami

Sermaxhaj dhe stafit të tij, vajzat dardane po punojnë me përkushtim maksimal për të qenë gati për këto duele të rëndësishme.

Ekipi verdh e kaltër do të përballlet me Maqedoninë e Veriut në udhëtim më 21

shkurt, ndërsa katër ditë më vonë (25 shkurt) do ta presë Letoninë në shtëpi.

Dardanet synojnë të bëjnë paraqitje sa më të mira në sfidat e shkurtit dhe të nxjerrin sa më shumë pikë që të jetë e mundshme.



# Zidane po zhvillon një biznes të madh, investoi 5 milionë euro në një qytet me 10 mijë banorë

TOULOUSE, 18 SHKURT - Zinedine Zidane do ta hapë zyrtarisht qendrën e katërt sportive "Z5" vitin e ardhshëm, me fusha futbollit dhe padel, të cilat do të jenë një kompleks sa natyror dhe ekonomik.

Në pritje të ardhjes së tij të mundshme në krye të kombëtares franceze, Zinedine Zidane vazhdon t'i zhvillojë aktivitetet e tij të biznesit.

Trajneri 52-vjeçar, i cili do të pasojë Didier Deschamps në krye të "Gjelave" pas Kupës së Botës 2026, do ta hapë qendrën e tij të katërt sportive "Z5" vitin e ardhshëm.

Sipas "L'Indépendant", ish-trajneri i Real Madridit, i cili ka mbetur pa punë që nga vera e vitit 2021, ka vendosur të investojë pesë milionë euro me të afërmit e

tij për të hapur një kompleks në Pyrenees-Orientales.

Qendra krejt e re do të vendoset në Toulouges, një qytet në kufi me Perpignan, i cili ka më pak se 10 000 banorë. Ai do të përmbajë fusha futbollit me pesë anë dhe fusha padeli, dhe është planifikuar një zonë sportive dhe rekreative "France 98".

Qyteti Toulouse është zgjedhur për afërsinë e tij me Spanjën, autostradën A9 dhe zonat ekonomike Naturopole dhe Grand Saint-Charles.

Do të jetë "një hapësirë e vërtetë jetese në të cilën do të përqendrohen aktivitetet e preferuara sportive të Zinedine Zidane", ka p e r m b l e d h u r "L'Indépendant".

Lansimi i "Z5" të ri do të vijë



20 vjet pasi Zidane i ka dhënë fund karrierës së tij. Kampioni i botës i vitit

1998, i cili ka luajtur për Cannes, Bordeaux, Juventus dhe Real Madrid, tashmë ka

nisur tri qendra të të njëjtit lloj, në Istres, Aix-en-Provence dhe Torino.

## Malisheva i kthehet fitores, mposht Ferizajn



Malishevë, 18 shkurt - Malisheva i është rikthyer fitores në Superligën e futbollit.

Skuadra e Bekim Isufit e ka mposhtur Ferizajn në ndeshjen e fundit të xhiros së 20-të të ligës elitare. Vendësit kanë fituar me

rezultat 3:2 duke i dhënë fund serisë prej katër ndeshjesh pa fitore.

Golat për mikpritësit i kanë shënuar Dreni Kryeziu, Laurent Xhylani dhe Drilon Hazrollaj. Falë kësaj fitoreje, Malisheva e ka përforcuar pozitën e

tretë në tabelë me 33 pikë, tri më pak se Ballkani, i cili është i dyti. Ndërkohë, Ferizaj e lëshoi mundësinë që të ngrehet në tabelë, ndërsa e sheh veten në një pozitë të rrezikshme, atë të tetë me 23 pikë.

## Vinicius blen një klub ambicioz evropian, dëshiron ta fusë në elitë me klubet e mëdha

Madrid, 18 shkurt - Vinicius Junior është bërë pronar i klubit portugez të kategorisë së dytë Alverca.

Një konsorcium investitorësh brazilianë dhe spanjollë, duke përfshirë yllin e Real Madridit, Vinicius, ka përfunduar blerjen e këtij ekipi.

"FC Alverca njofton se Ricardo Vicintin ka shitur aksionet e tij në kompaninë

publike të kufizuar te një grup investitorësh spanjollë dhe brazilianë", ka njoftuar FC Alverca.

Vinicius dhe bashkëpunëtorët e tij kanë investuar 8 milionë euro në këtë operacion.

Vinicius Junior është një nga futbollistët më të mirë në botë dhe vlen 200 milionë euro, sipas Transfermarkt. Ai fiton rreth 20 milionë euro në

sezon dhe kontrata e tij me Real Madridin zgjat deri në verën e vitit 2027.

Këtë sezon ai ka shënuar 16 gola dhe 12 asistime në 31 ndeshje.

Alverca aktualisht është skuadra e dytë në kampionat dhe ka ambicie të mëdha për të luajtur në elitën e sezonit të ardhshëm kundër gjigantëve si Benfica, Porto dhe Sporting.






**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të datës 14.02.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 19.02.2025 të shpall:

**KONKURS**

**Një (1) Vozitës i kategorisë "C"**- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 14-02-32  
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme  
Lartësia e pagës mujore: 428.56 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas Urdhresës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtinë të tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e mugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhresës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhresën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letërën e re të njohur ndërsa letërën paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letërën e tahograftit ka obligim që në të të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhresën e punës;
- Në rast nevojë ndron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Cdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejt;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave të përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhresës së udhëheqësit drejtpërdrejt, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjathtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspenziv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muajt).

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 19.02.2025 deri me 05.03.2025, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj" p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [krmuniteti@yahoo.com](mailto:krmuniteti@yahoo.com)

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të parapara nuk pranohen.



Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë [lurnshpk@gmail.com](mailto:lurnshpk@gmail.com) Nr tel: 045510011&46 143401&45 690 141

Prishtinë, 13.02.2025

**NJOFTIM PUBLIK**

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energi (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për "Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: [lurnshpk@gmail.com](mailto:lurnshpk@gmail.com) dhe [LEGAL-LENCENSING@ero-ks.org](mailto:LEGAL-LENCENSING@ero-ks.org)

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Neti" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810324814 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Neti" D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810324814 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Neti" L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 810324814 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Shaban Fetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Muhamet Laçi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Selmon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues të biznesit me nr. 810120684.

- Mërgim Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh,m,t "Nexhmedin Nixha" A. Mekanik.

- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. "Abdyl Frashëri" Prishtinë Bukëpjekës.

- Dulë Gjuraj Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Aroni DF" SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.

Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muajt), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 414/1  
Dt: 18.02.2025

Në bazë të nenit 95, 96 dhe 97 të Ligjit për Zyrtaar Publik, neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr.04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), neni 5 dhe 6 të Rregullorës (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat Konkurrimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren	Prizren	Dy (2) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e	Vendi lirë	2

**Titulli i pozitës së punës:** Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e  
**Klasa/ Koefficienti:** I23-3.76  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar  
**Orari:** 40 orë pune në javë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit shkollor;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- Ndihmon stafin në rregullimin e orendive të shkollës dhe në realizimin e punëve teknike;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe punë tjera të cilat i ndan drejtori i shkollës.

### Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma e shkollës e mesme;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës (nëse ka përvojë);
- Të ketë shkathtësi pune të pavaruar dhe në ekip;

### Dokumente që kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formulari i aplikimit (merret dhe dorëzohet në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (të noterizuara)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (sjellet nga kandidati pas përzgjedhjes, para nënshkrimit të kontratës)
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje

### Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit - CV (deri në 30 pikë)
- Intervita me gojë (deri në 70 pikë)

### Mënyra e njoftimit me rezultatet:

- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në tabelën e shpalljeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes nga data 19.02.2025 deri me datën 05.03.2025. Aplikacionet duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendra e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren.

### Sqarime shtesë:

- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtaarë Publikë;
- Aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 413/1  
Dt: 18.02.2025

Në bazë të nenit 95, 96 dhe 97 të Ligjit për Zyrtaar Publik, neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr.04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), neni 5 dhe 6 të Rregullorës (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat Konkurrimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
QeK	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Dy (2) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e	Vendi lirë	2

**Titulli i pozitës së punës:** Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e  
**Klasa/ Koefficienti:** I23-3.76  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar  
**Orari:** 40 orë pune në javë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit shkollor;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- Ndihmon stafin në rregullimin e orendive të shkollës dhe në realizimin e punëve teknike;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe punë tjera të cilat i ndan drejtori i shkollës.

### Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma e shkollës e mesme;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës (nëse ka përvojë);
- Të ketë shkathtësi pune të pavaruar dhe në ekip;

### Dokumente që kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formulari i aplikimit (merret dhe dorëzohet në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (sjellet nga kandidati pas përzgjedhjes, para nënshkrimit të kontratës)
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje

### Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit - CV (deri në 30 pikë)
- Intervita me gojë (deri në 70 pikë)

### Mënyra e njoftimit me rezultatet:

- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në tabelën e shpalljeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes nga data 19.02.2025 deri me datën 05.03.2025. Aplikacionet duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi".

### Sqarime shtesë:

- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtaarë Publikë;
- Aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

